



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 35 prot.

Kamëz, më 16.03 2021

VENDIM

Nr. 30, datë 16.03 2021

PËR
MIRATIMIN E LISTËS SË FAMILJEVE QË JANË REKOMANDUAR NGA
ADMINISTRATORET SHOQËRORE PËR TRAJTIM ME FONDIN 6% TË BLOK-
NDIHMËS EKONOMIKE

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot më 16.03.2021 në kushte të veçanta si pasojë e masave të ndërmarra për parandalimin e përhapjes së virusit COVID-19, pasi mori në shqyrtim Projekt – Vendimin Nr.27 Datë 11.03.2021, mbështetur në Ligjin 57. Date 18.07.2019 "Mbi Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë" neni 21, VKM – në nr.956, datë 07.12.2016 "Për përcaktimin e kriterëve dhe të detajeve të formulës së unifikuar të pikëzimit për përfitimin e ndihmës ekonomike dhe shërbimet shoqërore" Kreu IV, pika 2 të Vendimit nr. 955 datë 07.12.2016, të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike" të ndryshuar dhe Udhëzimit nr.5, datë 17.02.2017 "Mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6%" të ndryshuar dhe VKM 597 dt., 04.09.2019 kreu 4 pika 3 "Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike". Dhe në VKB nr 158 datë 18.12.2020 "Mbi miratimin e kriterëve për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet që nuk janë përfituese nga sistemi i pikëzimit", Këshilli Bashkiak Kamëz:

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së muajit Shkurt, prej 45 familjeve që janë rekomanduar nga administratoret shoqëror për fondin 6% të bllok-ndihmës ekonomike. Fondi për këto familje është 305,640 (treqind e pesë mijë e gjashtëqind e dyzetë) lekë.
2. Lista e familjeve të cituara në pikën 1 të këtij projekt-vendimi paraqitet në Aneksin bashkëlidhur dhe është pjesë e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Tiranë.

Nën/ Kryetar Këshilli
Ali Dauti

